

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - ankesa e refuzuar - kriteret për pranimin e të drejtës për ndihmë sociale Rregullorja e UNMIK-ut 2003/28 - Neni 42 (2) LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale Departamenti i Mirëqenies Sociale në Prishtinë, duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ kishte shkelur rregullat procedurale, kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike dhe kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale.*

*Qendra për Punë Sociale në Malishevë refuzoi t'ja ndajë ndihmën sociale paditësit për shkak se ajo nuk kishte përmbushur kërkesat për ndarjen e ndihmës sociale.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës së parë dhe i padituri kishin vërtetuar se familja e paditësit nuk kishte përmbushur kërkesat për ndarjen e ndihmës sociale për shkak se është gjetur se paditësi ka fëmijë të rritur të cilat janë të aftë për punë dhe të ushtrojnë veprimtari ekonomike siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/28 mbi skemën e ndihmës sociale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë.*

A.nr.1/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtarë, me bashkëpunëtoresh profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëses H. D., nga fshati Shkarashnik, Komuna Malishevë, kundër aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Mirëqenies Sociale në Prishtinë, nr.091 datë 16.09.2004, në lëndën e ndihmës sociale, në seancën jopublike të kolegjit të mbajtur me datë 10.03.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet padia.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar ankesa e paditëses kundër aktvendimit të Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicë, nr.30/415 datë 16.09.2004, me të cilin nuk i pranohet e drejta në ndihmë sociale, sepse familja e paditëses nuk paraqet rast social.

Paditësja në padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar për shkak të shkeljeve esenciale të rregullave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke pohuar se paditësja jeton me dy vajzat e saj në kushte të rënda ekonomike pa kurrfarë burimi të ardhurave. Propozon që padia të aprovohet e aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Organi i paditur nuk ka dhënë përgjigje në padi.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në drejtim të theksimeve të padisë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se:

Padia është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se organet administrative në procedurën e zhvilluar administrative, me rastin e verifikimit se a i përmbush paditësja kushtet e parashikuara me Rregulloren e UNMIKut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndihmës Sociale, kanë konstatuar se familja e paditëses nuk paraqet rast të nevojës sociale, sepse familja ka anëtarë të aftë për punë dhe veprimtari ekonomike.

Instituti i paditur, në procedurën sipas ankesës me aktvendimin e kontestuar e ka pranuar në tërësi gjendjen e vërtetuar faktike dhe qëndrimin juridik të organit të faktit - shkallës së parë, për çka ka refuzuar ankesën dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e kundërshtuar.

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndihmës Sociale, në nenin 1 përcakton se familja e rrezikuar në aspektin social është ajo familje që përzgjidhet për ndihmë sociale. Në nenin 4 pika 1 kjo rregullore parasheh se, për të fituar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive vijuese: (a) kategoria e parë e cila në bazë të nenit 2 pika 7 të rregullores nënkupton familjen në të cilën të gjithë anëtarët janë të varur përkatësisht janë të paaftë për punë shpërblyese dhe (b) kategoria e dytë - familja e cila ka një anëtar të aftë për punë dhe të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare apo që nën përkujdesje ka një jetim nën moshën 15 vjeçare ose duhet të jenë të varur në kuptim të nenit 2.7 të kësaj rregullore.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme konkludon, se

organi i faktit dhe ai i paditur kanë vërtetuar se familja e paditëses nuk i plotëson kushtet ligjore të parashikuara për njohjen e së drejtës së ndihmës sociale, sepse paditësja jeton me fëmijët H., B. dhe M. të moshës madhore të aftë për punë dhe veprimtari ekonomike. Këto të dhëna u vërtetuan edhe me datën 03.04.2004, nga Komisioni për Monitorim i organit të faktit çka rezultoi nga formulari për verifikimin e gjendjes sociale të paditëses.

Duke i pasur parasysh faktet jokontestimore në këtë çështje të ndihmës sociale, Gjykata konstaton se organi i faktit dhe ai i paditur nuk e kanë cënuar ligjin dhe Skemën e Mirëqenies Sociale në dëm të paditësit sepse në vështrim të nenit 8 dhe 10 të Ligjit mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare ("Gazeta Zyrtare e KSAK" nr.8/84) është paraparë që fëmijët e aftë për punë janë të obliguar të mbajnë dhe të sigurojnë mjete për ekzistencën e prindërve të tyre, në rastin konkret paditësja pa marrë parasysh se a jeton në të njëjtën bashkësi familjare.

Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cënuar ligji në dëm të paditëses, andaj theksimet e padisë nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendjeje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organeve administrative, kështu që, në vështrim të nenit 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

A.nr.1/2005, datë 10.03.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna GashiKryetar i kolegjit,  
Osman Tmava**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e hedhur poshtë - e drejta për pension invalidor - Neni 40 (1) LKA/ Neni 1 42 (1) LKA/ Neni 1.1 i Rregullorës së UNMIK-ut Nr.2000/66]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur administrativ kishte vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike dhe kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke mos konsideruar se shkalla e invaliditetit ishte më e lartë se 40%, që është kërkesë për ndarjen e pensionit invalidor.*

*Departamenti i Mirëqenies Sociale refuzoi të ndajë pensionin invalidor paditësit për shkak se komisioni i mjekëve kishte vlerësuar se shkalla e invaliditetit ishte më e ulët se 40%.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës së parë dhe i padituri kishte zbatuar drejtë ligjin për shkak se provat administrative pa dyshim provonin se paditësi nuk përmbush kërkesat për ndarjen e ndihmës siç parashikohet me nenin 5 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/66. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë.*

A.nr.3/2005

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, procesmbajtëse Ajna Gashi, bashkëpunëtore profesionale, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit H. H., nga fshati Nerodime e Poshtme, Komuna Ferizajt, kundër anës së paditur Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale - Udhëheqësit të Departamentit të Mirëqenies Sociale për anulimin e aktvendimit nr.06.02/458 datë 8.12.2004, në seancën e mbajtur më 17.05.2005, mori këtë

## A K T G J Y K I M

Refuzohet padia.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Departamentit të Mirëqenies Sociale - Komisionit për ankesa 06-02/458 datë 26.10.2004, me të cilin është refuzuar kërkesa që paditësit t'i njihet e drejta e pensionit invalidor.

Paditësi në padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke pohuar se shkalla e invaliditetit tek ai është mbi 40%, sa është parashikuar për njohjen e së drejtës së kërkuar. Propozon që padia të aprovet e aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Organi i paditur në përgjigje në padi propozon që padia të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në drejtim të theksimeve të padisë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par.1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), gjeti se padia nuk është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë, me aktvendimin nr.06-02/458 datë 26.10.2004, ka refuzuar kërkesën e paditësit që t'i njihet e drejta e marrjes së ndihmës financiare nga Fondi i veçantë për invalidët e veçantë të luftës, sepse Komisioni Qendror Mjekësor i anës së paditur, në konstatimin me mendimin e tij të datës 23.04.2004, ka vlerësuar se shkalla e invaliditetit tek paditësi është nën 40%. Në procedurën sipas ankesës, ana e paditur ka siguruar konstatimin dhe mendimin e Komisionit mjekësor të sipërcekur, i cili bëri rishqyrtimin dhe vlerësimin e shkallës së invaliditetit tek paditësi më datë 22.10.2004 me që rast konfirmoi mendimin e komisionit të mëparshëm mjekësor, dhe duke gjetur se procedura që i ka paraprirë aktvendimit të kontestuar është zbatuar drejt nga organi i shkallës së parë dhe se, e drejta materiale është zbatuar drejt, refuzoi ankesën.

Me dispozitën e nenit 1.1 të rregullores nr.2000/66 "Për beneficionet e invalidëve të Kosovës dhe për më të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë", invalid i luftës konsiderohet çdo person që ka marrë plagë fizike si pasojë e drejtëpërdrejtë e konfliktit të armatosur në Kosovë, niveli minimal i lëndimit të të cilit përkufizohet me anë të një urdhërese administrative të lëshuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Në nenin 2.1 të udhëzimit administrativ nr.2001/9 "Për plotësimin e rregullores nr.2000/66 për beneficionet e invalidëve të luftës të Kosovës dhe për më të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë", parashikohet se pagesat për ivalidët e luftës do të kryhen varësisht nga niveli i aftësisë së tyre fizike të konstatuar nga Komisioni qendror

mjekësor në bazë të shkallëve vijuese të pagesës:

- a) 70-100% paaftësi fizike: shkalla e parë e pagesës dhe
- b) 40-69% paaftësi fizike: shkalla e dytë e pagesës, ndërsa në nenin 2.2 parashikohet se nuk do të marrin kurrfarë ndihmash personat me nivel të paaftësisë fizike më pak se 40%.

Duke pasur parasysh se komisioni mjekësor i anës së paditur, me ligj i autorizuar, ka konstatuar se tek paditësi shkalla e invaliditetit është më e ulët se 40% Gjykata konstaton se organi i shkallës së parë dhe ana e paditur drejt kanë aplikuar dispozitën e nenit 5 të Rregullores së sipërcekur të UNMIK-ut, në bazë të cilës është refuzuar kërkesa e paditësit.

Gjykata vlerësoi theksimet e padisë dhe konstatoi se të njëjtat në këtë çështje administrative nuk kanë ndikësë në vendosjen tjetër, meqë me provat e administruara e në vështrim të dispozitave të cekura ligjore pa mëdyshje është vërtetuar që paditësi nuk plotëson kushtet ligjore për njohjen e së drejtës së kërkuar.

Nga sa u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me nenin 42 par.1 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

A.nr.3/2005, datë 17.05.2005

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Ajna Gashi, procësbajtëse

Kryetar i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - ankesa e pranuar pjesërisht - kujdestaria e fëmiut - kontakti prindor - Neni 40 (1) LKA/Neni 117 LMFR]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Instituti i Politikës Sociale në Prishtinë për shkak të prishjes së aktvendimit të shkallës së dytë përkritazi me kontaktin A. D. me fëmiun e mitur.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se si organi i shkallës së parë ashtu edhe ai i shkallës së dytë kishte zbatuar drejtë dispozitat e procedurës administrative dhe nenin 117 të Ligjit për Martesën dhe Marrëdhëniet Martesore gjatë marrjes së vendimit për formën e kontaktit ndërmjet nënës dhe fëmiut. Gjykata Supreme ka vendosur se me qëllim të zhvillimit adekuat fizik dhe psikik të fëmiut, është i domosdoshëm për të siguruar kontaktin e fëmiut me të dy prindërit.*

*Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte pjesërisht e bazuar dhe urdhëroi të paditurin se gjatë rivendosjes të caktojë datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e kontaktit të nënës dhe fëmiut.*

A.nr.9/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Osman Tmava dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit M. H., nga Peja, të cilin e përfaqëson Blerim Hoxha, avokat nga Peja kundër anës së paditur Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale - Instituti i Politikës Sociale Prishtinë, për anulimin e aktvendimit të shkallës së dytë nr.02.1522 datë 15.12.2004, në seancën e mbajtur më 21.03.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

PRANOHET padia vetëm për sa i përket kontaktit të A. D. me fëmijën e saj të mitur, A., gjatë pushimeve verore e dimërore, festave fetare e shtetërore dhe ditëlindjeve, kurse lidhur me këtë pjesë aktvendimi i anës së paditur, nr.02.1522 datë 15.12.2004 ANULOHET; ndërkaq, po kjo padia REFUZOHET si e pabazuar lidhur me pjesën me të cilën është vërtetuar aktvendimi i organit të shkallës së parë nr. 721/04 datë 08.09.04.

**A r s y e t i m i**

Ana e paditur, duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar kundër aktvendimit të Qendrës për Punë Sociale Pejë nr. 721/04, datë 08.09.04, me par.1 të aktvendimit të kontestuar e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e Qendrës për Punë Sociale në Pejë nr. 721/04, me të cilin është miratuar kërkesa e A. D. dhe kontakti i saj me fëmijën e saj të mitur, A. H., është rregulluar ashtu që nëna do të kontaktojë me të çdo të 15 dhe të 30 ditë të muajit; me par.2, aktvendimin e shkallës së parë e ka ndryshuar, ashtu që mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të nënës A. D. me fëmijën e saj të mitur, A. H., e ka rregulluar ashtu që, përveç kontaktimit të përcaktuar me aktvendimin e organit të shkallës së parë, nëna do të kontaktojë me fëmijën edhe me rastin e festave shtetërore dhe fetare, pushimeve verore dhe dimërore dhe me rastin e ditëlindjeve; me par.3 ka konstatuar se aktvendimi është i plotëfuqishëm deri në nxjerrjen e aktvendimit për besimin e fëmijës, respektivisht deri në ndryshimin eventual të rrethanave që kanë ndikuar në nxjerrjen e një aktvendimi të tillë; me par.4 ka konstatuar se ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Paditësi në padinë, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktvendimit të Shkallës së dytë, thekson se aktvendimi i anës së paditur është i paligjshëm, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe shkeljes së dispozitave të procedurës së përgjithshme administrative. Ka propozuar që padia të pranohet dhe vendimi i kontestuar të anulohet.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi vlerësoi aktvendimin e kontestuar në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par.1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), gjeti se padia është pjesërisht e bazuar.

Për zhvillimin e mirë psikofizik të fëmijës është shumë i nevojshëm kontakti me të dy prindërit. Kontaktet dhe shoqërimet me prindin me të cilin fëmija nuk jeton në bashkësi familjare, janë zëvendësim për jetën e përbashkët me të dy prindërit.

Vendimin për rregullimin e mbajtjes së kontakteve personale të fëmijës me prindin që nuk e ushtron të drejtën prindërore organi i kujdestarisë e merr në radhë të parë në interesin e fëmijës, që të sigurohet mbajtja e lidhjes ndërmjet fëmijës dhe prindit, me qëllim të kultivimit të ndjenjave dhe raporteve të ndërsjellta të tyre. Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, organi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës së përgjithshme administrative dhe dispozitat e nenit 117 të Ligjit mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare, kur kanë vendosur për mënyrën e mbajtjes së

kontakteve personale të nënës me fëmijën çdo të 15 dhe 30 ditë të muajit. Lidhur me këtë pjesë, Gjykata Supreme, në përputhje me dispozitën e nenit 42 par.2 të LKA, e refuzoi padinë.

Për konfliktin Gjykata vendos, si parim, në bazë të fakteve të cilat janë vërtetuar në procedurën administrative.

Gjykata Supreme ka gjetur se akti i kontestuar në pjesën me të cilën është vendosur për kontaktet personale të fëmijës me nënën gjatë pushimeve verore dhe dimërore, festave dhe ditëlindjeve nuk mund të shqyrtohet për arsye se në atë pjesë të aktit nuk janë caktuar data e fillimit dhe kohëzgjatja e këtyre takimeve. Për sa i përket kësaj pjese, në përputhje me dispozitën e parashikuar me nenin 39 par.2 të LKA, kjo Gjykatë e pranoi padinë dhe atë pjesë të aktvendimit e anuloi.

Gjykata Supreme, bazuar në autorizimet e parashikuara nga neni 62 i LKA, e obligon anën e paditur që në riprocedurë të caktojë datën e fillimit dhe kohëzgjatjen e kontaktit të nënës me fëmijën, veçmas gjatë pushimeve verore dhe dimërore, festave shtetërore dhe fetare si dhe me rastin e ditëlindjeve.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
A.nr.9/2005, datë 21.03.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Vjosa Nimani-Zylfiu

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e pranuar - vendimi i prishur dhënia e tokës për ndërtim urban për shfrytëzim - pengim posedimi - Neni 40 (1) LKA/Neni 62 LKA/Neni 263 (1)/Neni 265 LKA/Neni 209(1,2)/Neni 39 (2)/Neni 42 (2) LKA]**

*Paditësit paraqitën ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duke bërë pretendimin ankimor se organet administrative nuk kanë provuar faktet relevante të cilat ishin me rëndësi dhe si rrjedhojë ka nxjerrë konkluzione të gabueshme në dëm të paditësit.*

*Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mkedisit i komunës së Gllogovcit urdhëroi paditësin të largojë objektin e biznesit nga toka urbane e cila i ishte dhënë atij për shfrytëzim.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme përkitazi me gjendjen faktike dhe bazat ligjore dhe pretendimet ankimore se paditësi me vendim të formës së prerë fitoi posedimin ndaj tokës urbane, i cili mdyshoi regjimin e shfrytëzimit në posedim të përhershëm dhe fitoi lejen për ndërtim në bazë të aktvendimit të formës së prerë të organit kompetent. Pas hyrjes në fuqi, këto aktvendime prodhojnë pasoja juridike. Në këtë drejtim nuk janë dhënë arsye përkitazi me kushtet të cilat parashikojnë prishjen e aktvendimit siç parashihet me nenin 263 (1) dhe 265 të LKA. Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës së parë dhe i padituri shkelën ligjin në dëm të paditësit për shkak se vendimi ishte marrë para se faktet relevante të rastit ishin vërtetuar plotësisht dhe drejtë. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë.*

A.nr.15/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëses A. O., nga Gllogovci, të cilën me autorizim e përfaqëson Feriz Gërvalla, avokat nga Prishtina, kundër vendimit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, A.nr.100/2004 datë 19.11.2004, përkitazi me dhënien në shfrytëzim të tokës ndërtimore urbane, në seancën e mbajtur më 21.03.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Aprovohet padia.

Anulohet, vendimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor në Prishtinë, A.nr.100/2004 datë 19.11.2004

### A r s y e t i m i

Me vendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses e është vërtetuar aktvendimi i Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës së Glllogovcit, 01 nr.353-502 datë 18.06.2004, me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit është vërtetuar aktvendimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Ambientit, nr. 353/378 datë 5.05.2004, sipas të cilit paditësja ka detyrim që lokalin afarist të e largoi nga toka ndërtimore urbane e cila i është dhënë për shfrytëzim.

Paditësja në padi konteston ligjshmërinë e vendimit të kontestuar për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike duke theksuar se me rastin e vendosjes organet administrative nuk vërtetuan faktet relevante, të rëndësishme për vendosjen e drejtë të kësaj çështje juridike-administrative dhe për këtë arsye thekson se ka ardhur deri te konkluzia e gabuar në vendimin e kontestuar, në dëm të paditëses e për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave të ligjit material dhe atij procedural. Propozon që padia të aprovohet e vendimi i kontestuar të anulohet.

Në përgjigje të padisë, organi administrativ i paditur i konteston theksimet e padisë, mbetet pranë arsyeve të dhëna në vendimin e kontestuar dhe propozon që padia të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, sipas nenit 40 par.1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në drejtim të theksimeve nga padia, përgjigjes në padi dhe pas shqyrtimit të shkresave në lëndë konstatoi : se padia është e bazuar.

Nga shkresat në lëndë del se me aktvendimin e Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Glllogovcit nr. 351-127 datë 29.03.2001, është urdhëruar paditësja që menjëherë të largojë lokalin afarist, me të gjitha të mirat materiale që gjenden brenda dhe rreth objektit-lokalit. Paditësja kundër atij aktvendimi paraqet ankesë Kryeshefit Ekzekutiv të komunës së Glllogovcit, për të cilën nuk ka marrë përgjigje, për çka paraqet kërkesë të përsëritur por prap nuk merr përgjigje, ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës sipas padisë së paditëses me aktgjykimin A.nr.19/2001 datë 27.07.2001, aprovon padinë e paraqitur dhe Kryeshefin Ekzekutiv të komunës së Glllogovcit, urdhëron që në afat prej 30 ditëve të vendos sipas ankesës së paditëses dhe të vepron në pajtim

me nenin 62 të LKA. Rezulton se Gjykata Komunale në Glllogovc, me aktvendimin C.nr.53/2001 datë 18.06.2001, aprovon padinë e paditëses dhe vërteton se e paditura Komuna e Glllogovcit, në posedim i ka penguar pronarët e objekteve-lokaleve afariste të cilat gjenden në vendin e quajtur "Ashanajka" Rr. "Skëndërbeu" në Glllogovc ku gjendet edhe lokali i paditëses, ndërsa Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me aktgjykimin Ac.nr.358/2001 datë 24.12.2001, refuzon si të pabazuar ankesën e të paditurës, Komuna e Glllogovcit dhe vërteton aktvendimin e atakuar të sipërcekur, të Gjykatës së Shkallës së Parë. Njëherit, Drejtorati për Inspektionin i komunës së Glllogovcit, me Konkluzionin nr. 351-60 datë 25.02.2002, lejon ekzekutimin e aktvendimit të asaj Drejtorie, nr.351-127 datë 29.03.2001, duke vlerësuar se çështja ekzekutive është vendosur me aktvendimin e plotëfuqishëm, të sipërcekur të Gjykatës Komunale në Glllogovc. Sipas kërkesës së Ombudspersonit të Kosovës, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovën me Urdhërin Ekzekutiv, nr. 2001/6 datë 7.05.2001, shtyen ekzekutimin, dhe në zbatim të tij Asambleja Komunale e Glllogovcit, me vendimin e datës 24.08.2001 gjithashtu shtyen ekzekutimin deri në marrjen e aktvendimit të ri. Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin A.nr. 104/2002 datë 22.01.2004, pranon padinë e paditësit dhe anulon konkluzionin e kontestuar të sipërcekur të organit të shkallës së parë duke udhëzuar për detyrueshmërinë e vërejtjeve të dhëna në pajtim me nenin 62 të LKA.

Nga shkresat në lëndë gjithashtu rezulton se me aktvendimin e organit të shkallës së parë - Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Ambientit të komunës së Glllogovcit, nr. 353-378 datë 5.05.2004, është anuluar aktvendimi i komunës së Glllogovcit, nr. 353-59 datë 22.04.1992, sipas të cilit paditësja në shfrytëzim ka marrë tokën ndërtimore urbane në sipërfaqe prej 24 m2, për destinim afarist e cila gjendet në lokacionin nr.45, pjesë e ngastrës kadastrale nr. 763, e cila gjendet në Glllogovc në vendin e quajtur, "Ashanajka" në Rr. "Skëndërbeu". Paditësi njëherit është urdhëruar që në afat prej 8 ditësh nga hapsira urbane të largojë objektin-lokalin e ndërtuar afarist, me kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

Në procedurën sipas ankesës Kryeshefi Ekzekutiv i Komunës së Glllogovcit, me aktvendimin nr. 355-502 datë 18.06.2004, refuzon si të pabazuar ankesën e paditëses e vërteton aktvendimin e atakuar të organit administrativ të shkallës së parë, duke i pranuar në tërësi arsyet e dhëna në aktvendimin e atakuar.

Edhe organi administrativ i paditur me vendimin e kontestuar refuzon si të pabazuar ankesën e paditëses e vërteton aktvendimin e atakuar të sipërcekur të Kryeshefit Ekzekutiv të Komunës së Glllogovcit, me arsyetim se toka urbane është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm, se ka skaduar afati kontraktues i shfrytëzimit të tokës urbane, për çka paditësi do të duhej vullnetarisht të largojë objektin-lokalin afarist nga hapsira urbane, se

procedurat e zhvilluara administrative lëndë shqyrtimi kanë pengimin në posedim ndërsa urdhri për mosveprim i lëshuar nga PSSP-Kryeadministratori i Kosovës dhe organeve të tjera, nuk kanë objekt shqyrtimi dhe vendosje objektin i cili shqyrtohet në këtë çështje juridiko-administrative edhe duke u bazuar në dispozitën e nenit 240 par.1 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative (LPPA), ka vlerësuar se në rastin konkret nuk është deshtë të veprohet në pajtim me nenin 263 dhe 265 të LPPA.

Nisur nga kjo gjendje e fakteve, Gjykata konstaton se në rastin konkret organet administrative në vendimet e kontestuara nuk kanë dhënë arsye për faktet me rëndësi vendimtare, konkretisht se a është vepruar sipas aktgjyqimeve të kësaj Gjykate A.nr. 19/2001 dhe A.nr.104/2002, vërejtjeve të dhëna të cilat bazohen në dispozitën e nenit 62 të LKA, fakte këto të rëndësishme për të vërtetuar se për lëndën e kontestit a kemi të bëjmë me një apo më shumë procese administrative. Sa i përket anulimit të aktvendimit për dhënie të tokës urbane në shfrytëzim dhe për qëndrimin juridik të marrë në aktvendimin e kontestuar të organit të shkallës së parë të cilin e pranon edhe organi i shkallës së dytë, kjo Gjykatë vlerëson se nuk u dhanë arsye të mjaftueshme dhe sa i përket bazës juridike dhe faktike e sidomos kur kemi parasysh theksimet nga padia se paditësja me vendim të formës së prerë ka marrë në shfrytëzim të përkohshëm tokën urbane të cilin regjim të shfrytëzimit e ka ndryshuar, në shfrytëzim të përhershëm, se lejen për ndërtim të objektit lokalit afarist e ka marrë në bazë të vendimit të formës së prerë të organit kompetent, administrativ vendime këto të plotëfuqishme të cilat edhe prodhojnë efekte juridike. Në këtë drejtim nuk u dhanë edhe arsye sa i përket kushteve të parapara për anulimin e vendimit, si parashifet me nenin 263 par.1 dhe 265 të LPPA.

Mosdhënja e arsyeve për faktet e rëndësishme për vendosjen e drejtë të çështjes, vendimin e kontestuar e bënë të jetë në kundërshtim me dispozitën e nenit 209 par.1 dhe 2 të LPPA. Në këtë kontekst arsyetimi i vlefshëm i aktvendimit sipas natyrës së çështjes edhe paraqet prezumim të domosdoshëm pa të cilin nuk është e mundur të vlerësohet rregullësia e gjendjes së vërtetuar faktike, rregullësia e procedurës së zhvilluar e sidomos asaj sipas ankesës dhe as ligjshmëria e aktit të kontestuar në kontekstin administrativ.

Duke pas parasysh konstatimet e sipërcekura, Gjykata konkludon se në këtë çështje administrative ekzistojnë kundërthënie të cilat nuk janë evituar gjatë vendosjes nga ana e organit të shkallës së parë dhe atij të paditur sepse nuk janë marrë parasysh provat në shkresat e lëndës dhe ato të cilat i prezantoj paditësi por edhe nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme për të dhënat nga të cilat do të mund të konkludohet se gjendja e fakteve është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Nga këto arsye Gjykata konstaton se me vendimin e kontestuar është cënuar ligji në dëm të paditëses sepse është marrë pa u vlerësuar në mënyrë të

drejtë dhe të plotë provat relevante në lëndë, që do të thotë në gjendje të pavërtetuar faktike duke mos u evituar kontradiktoriteti në mes të provave që i prezantoi paditësi dhe provave në të cilat bazohet vendimi i kontestuar e lidhur me detyrimin e caktuar për paditësin.

Në këtë drejtim Gjykata e obligon organin e paditur që në riprocedurë të veprojë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejtë dhe të ligjshme të kësaj çështje administrative. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur neni 62 i LKA.

Me sa u cek më lartë, Gjykata në vështrim të nenit 39 par.2 dhe nenit 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË  
A.nr.15/2005, datë 21.03.2005

Procesmbajtësja,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - ankesa e refuzuar - kriteret për pranimin e të drejtës për ndihmë sociale Rregullorja e UNMIK-ut 2003/28 ]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Mirëqenies Sociale në Prishtinë duke bërë pretendimin ankimor se organet administrative administrative kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishin bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke mos konsideruar se ajo ishte ndarë nga i biri i saj dhe se jeton në kushte tejet të vështira.*

*Qendra për Punë Sociale në Mitrovicë refuzoi të ndajë ndihmën sociale paditësit për shkak se ajo nuk kishte përmbushur kërkesat për ndarjen e ndihmës sociale.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës së parë dhe i padituri kishte vërtetuar se familja e paditësit nuk kishte përmbushur kriteret për ndarjen e ndihmës sociale për shkak se gjetja se paditësi kishte fëmijë të rritur të cilët janë të aftë për punë dhe për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/28 për Skemën e Ndihmës Sociale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë.*

A.nr.21/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëses Z. H., nga fshati Zhabar, Komuna Mitrovicë, kundër aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Mirëqenies Sociale në Prishtinë, nr.301 datë 16.12.2004, në lëndën e ndihmës sociale, në seancën jopublike të kolegjit të mbajtur me datë 10.03.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet padia.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar ankesa e paditëses kundër aktvendimit të Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicë, nr.00211 datë 18.11.2004, me të cilin nuk i pranohet e drejta në ndihmë sociale, sepse familja e paditëses nuk paraqet rast social.

Paditësja në padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke pohuar se paditësja është e ndarë nga djali i saj dhe për këtë posedon kontratë mbi ndarjen e bashkësisë familjare, jeton në gjendje të rëndë ekonomike pa kurrfarë burimi të ardhurave. Propozon që padia të aprovohet e aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Organi i paditur nuk ka dhënë përgjigje në padi.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në drejtim të theksimeve të padisë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se:

Padia është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se organet administrative në procedurën e zhvilluar administrative, me rastin e verifikimit se a i përmbush paditësja kushtet e parashikuara me Rregulloren e UNMIKut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndihmës Sociale, kanë konstatuar se familja e paditëses nuk paraqet rast të nevojës sociale, sepse ka anëtarë të aftë për punë dhe veprimtari ekonomike.

Instituti i paditur, në procedurën sipas ankesës me aktvendimin e kontestuar e ka pranuar në tërësi gjendjen e vërtetuar faktike dhe qëndrimin juridik të organit të faktit - shkallës së parë, për çka ka refuzuar ankesën dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e kundërshtuar.

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndihmës Sociale, në nenin 1 përcakton se familja e rrezikuar në aspektin social është ajo familje që përzgjidhet për ndihmë sociale. Në nenin 4 pika 1 kjo rregullore parasheh se, për të fituar të drejtën në ndihmë sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive vijuese: (a) kategoria e parë e cila në bazë të nenit 2 pika 7 të rregullores nënkupton familjen në të cilën të gjithë anëtarët janë të varur përkatësisht janë të paaftë për punë shpërblyese dhe (b) kategoria e dytë - familja e cila ka një anëtar të aftë për punë dhe të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare apo që nën përkujdesje ka një jetim nën moshën 15 vjeçare ose duhet të jenë të varur në kuptim të nenit 2.7 të kësaj rregullore.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme konkludon, se

organi i faktit dhe ai i paditur kanë vërtetuar se familja e paditëses nuk i plotëson kushtet ligjore të parashikuara për njohjen e së drejtës së ndihmës sociale, sepse është konstatuar se paditësja ka fëmijë të moshës madhore të aftë për punë dhe veprimtari ekonomike, vajzën S. dhe djali i cili ka krijuar marrëdhënie pune. Këto të dhëna u vërtetuan edhe me datën 16.09.2004, nga Komisioni për Monitorim i organit të faktit çka rezultoi nga formulari për verifikimin e gjendjes sociale të paditëses.

Duke i pasur parasysh faktet jokontestimore në këtë çështje të ndihmës sociale, Gjykata konstaton se organi i faktit dhe ai i paditur nuk e kanë cënuar ligjin dhe Skemën e Mirëqenies Sociale në dëm të paditësit sepse në vështrim të nenit 8 dhe 10 të Ligjit mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare ("Gazeta Zyrtare e KSAK" nr.8/84) është paraparë që fëmijët e aftë për punë janë të obliguar të mbajnë dhe të sigurojnë mjete për ekzistencën e prindërve të tyre, në rastin konkret paditësja pa marrë parasysh se a jeton në të njëjtën bashkësi familjare.

Lidhur me këtë, Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cënuar ligji në dëm të paditëses, andaj theksimet e padisë nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendjeje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organeve administrative, kështu që, në vështrim të nenit 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË  
A.nr.21/2005, datë 10.03.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e pranuar - vendimi i prishur- e drejta për ndihmë sociale - Neni 39 (2)/ LKA/ Neni 42 (2) LKA/ Neni 4 pika 1 e Rregullorës së UNMIK-ut Nr.2003/38]**

*Paditësit paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Këshillit për Ankesa pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në rastet e ndihmës sociale duke bërë pretendimin ankimor se organet administrative kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishin bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke mos konsideruar se ajo jeton nën kushte tejet të vështira ekonomike.*

*Qendra për Punë Sociale e Mitrovicës refuzoi të ndajë ndihmën sociale paditësit për shkak se ajo nuk kishte përmbushur kërkesat për ndarjen e ndihmës sociale.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës dhe i padituri kishte shkelur ligjin në dëm të paditësit, për shkak se ka marrë vendim pa vlerësuar provat relevante të rastit pa vërtetuar përfundimisht gjendjen faktike dhe pa e eliminuar kontradiktoritetin. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e bazuar.*

A.nr.22/2005

#### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava, kryetar, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëses B. K., nga Mitrovica, kundër aktvendimit të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale - Komisioni për Ankesa Prishtinë nr.219 datë 26.11.2004, në lëndën e ndihmës sociale, në seancën jopublike të kolegjit të mbajtur me datë 19.04.2005, mori këtë

#### A K T G J Y K I M

Aprovohet padia.

Anulohet aktvendimi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale-Komisioni për Ankesa Prishtinë nr.219 datë 26.11.2004

## A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar ankesa e paditëses kundër aktvendimit të Qendrës për Punë Sociale në Mitrovicë nr.04344 datë 18.10.2004, me të cilin nuk i pranohet e drejta në ndihmë sociale për arsye se paditësja nuk jeton në adresë të cilën ka dhënë më parë.

Paditësja me padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të atakuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke pohuar se paditësja jeton në të njëjtën adresë, mirëpo në momentet e vizitës nga organet përkatëse në teren nuk ka qenë në shtëpi, jeton vetëm, në kushte të rënda ekonomike pa kurrfarë burimi të të ardhurave. Propozon që padia të aprovohet e aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Organi i paditur nuk ka dhënë përgjigje në padi.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në drejtim të theksimeve të padisë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se:

Padia është e bazuar.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndihmës Sociale, në nenin 1 përcakton se familja e rrezikuar në aspektin social është ajo familje që përzgjidhet për ndihmë sociale. Në nenin 4 pika 1 kjo rregullore parasheh se, për të fituar të drejtën e ndihmës sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive vijuese:

(a) kategoria e parë e cila në bazë të nenit 2 pika 7 të rregullores nënkupton familjen në të cilën të gjithë anëtarët janë të varur përkatësisht janë të paaftë për punë shpërblyese dhe

(B) kategoria e dytë - familja e cila ka një anëtar të aftë për punë dhe të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare apo që nën përkujdesje ka një jetim nën moshën 15 vjeçare ose duhet të jenë të varur në kuptim të nenit 2.7 të kësaj rregullore ose të jenë të regjistruar si të papunësuar në Zyrat e Punësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Nga shkresat e lëndës del se, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, sipas ankesës i ka pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të Qendrës për Punë Sociale, ka refuzuar ankesën dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e ankimuar, kështu që vendimin e tyre e bazojnë në formularin për riverifikimin e gjendjes faktike të kryer në teren të datës 22.07.2004, në të cilën shënohet se pala nuk gjendet dhe se nuk banon në këtë adresë, ndërsa sipas të dhënave të dhëndrit të saj, kjo banon në lagjen "Bajr" në Mitrovicë.

Gjykata konkludon se në këtë çështje administrative ekzistojnë kundërthënie të cilat nuk janë evituar nga ana e organit të shkallës së parë dhe atij të paditur, sepse sipas vërtetimit të datës 02.07.2001, të Qendrës për Punë Sociale në Obiliq shënohet se paditësja nuk është shfrytëzuese e ndihmës së përhershme sociale, pran asaj qendre, njëherit në formularin për aplikim për ndihmë sociale nr. 01941 i datës 24.07.2002, rezulton se adresa e aplikantes është në Mitrovicë Lagja "Tamnik" Rr. "A.Hajrizi", ndërsa në formularin e verifikimit, datë 22.3.04, konstatohet se paditësja disa herë është kërkuar në adresën e shënuar por e njëjta nuk ka qenë prezent, ndërsa fqinjët e saj kanë deklaruar se ajo nuk banon në adresën e dhënë dhe se kurrë nuk ka banuar aty.

Nga këto arsye, Gjykata konstaton që me aktvendimin e kontestuar është cënuar Ligji në dëm të paditëses, sepse është marrur pa u vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha provat relevante në lëndë, që do të thotë në gjendje të pavërtetuar faktike, duke mos u evituar kontradiktoriteti se paditësja a banon me të vërtetë në adresën të cilën e ka shënuar, rruga "Shaban Polluzha" nr.27 Mitrovicë apo në lagjen e "Bajrit" siç deklaroi dhëndri i saj, apo në lagjen "Tamnik" Rr. "A.Hajrizi" Mitrovicë si është cekur në fletëaplikacionin e paditëses.

Në këtë drejtim, Gjykata e obligon organin e paditur që në riprocedurë t'i vlerësojë provat e administruara në lëndë, provat e prezantuara, e në rast nevojë, do të nxjerrë edhe prova të tjera, të cilat do të ndikojnë në vendosjen e drejtë dhe të ligjshme të kësaj çështje administrative.

Nga sa u cek më lartë, gjykata në vështrim të nenit 39 par.2 dhe nenit 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.nr.22/2005, datë 19.04.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi konfliktin administrativ - padia e hedhur poshtë - e drejta për pension invalidor - Neni 40 (1) LKA/ Neni 42 (1) LKA/ Neni 3 i Rregullorës së UNMIK-ut Nr.2003/40]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale duke bërë pretendimin ankimor se organet administrative kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke mos konsideruar gjendjen shëndetësore të saj dhe kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale në dëm të paditësit.*

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës refuzoi të ndajë pensionin e invaliditetit për shkak se komisioni i mjekëve vlerësoi se paditësi nuk ishte invalid i punës.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës së parë dhe i padituri kishte zbatuar drejtë ligjin për shkak se provat e administruara pa dyshim provojnë se paditësi nuk kishte përmbushur kërkesat për ndarjen e pensionit siç parashihet me nenin 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/40. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë.*

A.nr.34/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëses H. B. nga Prishtina, kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Këshilli i ankesave për pensionet invalidore, Prishtinë, pa numër datë 26.11.2004, në lëndën e pensionit invalidor, në seancën jopublike të mbajtur me datën 21.3.2005, mori

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet padia.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditëses e paraqitur kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës në Prishtinë, nr.5000800 datë 17.8.2004, me të cilin është refuzuar kërkesa e paditëses për njohjen e të drejtës në pension invalidor.

Paditësja me padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar duke pohuar se komisionet mjekësore të paditurës, nuk morën parasysh faktet se gjendja e saj shëndetësore është e rëndë, se nuk është e aftë për punë dhe

provat e prezentuara organet administrative nuk i morën parasysh, për çka edhe gjendja e fakteve nuk u vërtetua në mënyrë të plotë kështu edhe erdhi tek zbatimi i drejtës materiale në dëm të saj. Propozon që padia të aprovohet e të anulohet vendimi i kontestuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të vendimit të kontestuar sipas nenit 40 par.1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), vlerësimi të thënieve në padi dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës, gjeti se

Padia është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë, me vendimin nr.5000800 datë 17.8.2004, paditësit i refuzon kërkesën për njohjen e të drejtës në pension invalidor nga arsyeja se nuk i plotëson kriteret sipas nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/40 datë 17.12.2003 të Ligjit për Pensionet Invalidore në Kosovë, dhe të njëjtin e bazon në konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të organit të shkallës së parë, datë 11.8.2004, i cili vlerëson se te paditësja nuk është paraqitur kufizimi i përhershëm i aftësisë punuese si parashihet dispozita e sipërcekur ligjore.

Në procedurën e ankesës, organi i paditur siguron konstatimin dhe mendimin e komisionit mjekësor të paditurës nr.122295 datë 26.11.2004, për vlerësimin e komisionit mjekësor të pensioneve invalidore (personave me aftësi të kufizuara) të organit të faktit, i cili dakordohet me konstatimin dhe mendimin e komisioneve mjekësore, prandaj edhe me vendimin e kontestuar refuzon si të pabazuar ankesën e paditëses dhe vërteton vendimin e atakuar.

Duke pasur parasysh se komisionet mjekësore me ligj të autorizuar, kanë konstatuar se te paditësja nuk ekziston aftësia e kufizuar për punë, Gjykata konstaton se organet administrative drejtë kanë zbatuar dispozitën e nenit 3 të Ligjit të cekur më lart në bazë të cilit edhe është refuzuar kërkesa e paditëses që t'i njihet e drejta në pension invalidor.

Gjykata vlerësoi theksimet e padisë dhe konstatoi se të njëjtat në këtë çështje administrative nuk kanë ndikësë në vendosjen tjetër, sepse me provat e administruara në vështrim të dispozitave së cekur ligjore pa mëdyshje është vërtetuar që paditësja nuk plotëson kushtet ligjore për njohjen e së drejtës së kërkuar, prandaj në vështrim të nenit 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

A.nr.34/2005, datë 21.3.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e hedhur poshtë - Neni 35.2 of Rregullorja e UNMIK-ut2000/45/Neni 7 LKA/ Neni 35.3, kapitulli VI Rregullorja e UNMIK-ut 2000/45/ Neni 30 (1) pika 4 LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesën kundër aktvendimit të kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Suharekës duke bërë pretendimin ankimor se aktvendimi nuk është marrë në pajtim me ligjin.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se aktvendimi i kundërshtuar nuk ishte shqyrtuar në kontekst të nenit 35.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45 që parashikon se kryeshefi ekzekutiv duhet ta rishqyrtojë ligjshmërinë e vendimit si dhe procesin administrativ me të cilin është arritur ai vendim. Ai ose ajo duhet të ofrojë një përgjigje të arsyeshme me shkrim brenda një muaji ditësh nga data e pranimit të ankesës. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë.*

A.nr.35/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Vjosa Nimani dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit V. Rr. B. nga Suhareka, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson av. Zef Delhysa nga Prizreni, kundër vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv të komunës së Suharekës, 02.Nr. 1811/2004 datë 13.01.2005, në lëndën pronëso-ro-juridike, në seancën jopublike të mbajtur me datën 01.06.2005, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Hidhet poshtë padia.

**A r s y e t i m i**

Paditësi me padinë e paraqitur thekson se me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktvendimi i Drejtorisë pronëso-ro-juridike KK Suharekë i datës 25.11.2004 nr. 010-466-394/244. Pretendon se aktvendimi është marrë në kundërshtim me ligjin. Propozon që padia të aprovohet e vendimi i kontestuar të anulohet.

Duke vlerësuar si çështje paraprake lejshmërinë e padisë, Gjykata gjen se akti i kontestuar është marrë në vështrim të nenit 35,2 të Rregullores mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës nr.2000/45 të datës 11 gusht 2000, prandaj në këtë fazë të vendosjes, padia nuk është lejuar për këto arsye:

Në nenin 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative parasheh se konflikti administrativ mund të iniciohet kundër aktit administrativ të nxjerrë në shkallë të dytë por edhe kundër aktit administrativ të nxjerrë në shkallë të parë kundër të cilit ankesa nuk është lejuar.

Në nenin 35.3 të kapitullit të 6 të Rregullores mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë nr. 2000/45 të datës 11 gusht 2000, është parashikuar se nëse pala- qytetari nuk është i kënaqur me përgjigjen e kryeshefit ekzekutiv, parashtruesi i ankesës mund t'i drejtohet Pushtetit Qëndror i cili shqyrton ankesën dhe vendos për ligjshmërinë e atij akti brenda një muaji nga koha e pranimit të ankesës me vendim i cili duhet të arsyetohet me shkrim dhe t'i komunikohet parashtruesit të ankesës dhe kryeshefit ekzekutiv.

Duke pasur parasysh që akti i kontestuar është marrë në vështrim të nenit 35.2 të Rregullores së cituar, rrjedh se kundër të njëjtit nuk është lejuar padia sepse sipas nenit 35.3 të Rregullores mund t'i paraqitet ankesë Pushtetit Qëndror, për çka organi i paditur - kryeshefi ekzekutiv nuk e ka udhëzuar palën se cilit institucion administrativ të Pushtetit Qëndror duhet t'i paraqitet ankesa, çka kjo e bën të mangët udhëzimin për mjetin juridik dhe pala për këtë nuk mund të pësojë, pasoja juridike dhe këtë duhet të evitojnë dhe t'ia mundësojnë paditësit këtë të drejtë.

Me sa u cek edhe më lartë, gjykata në vështrim të nenit 35.3 të Rregullores së cekur më lartë e lidhur me nenin 30 par.1 pika 4 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

A.nr.35/2005, datë 01.06.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - duke vendosur mbi konfliktin administrativ - padia e pranuar - vendimi i prishur - e drejta në pension invalidor - Neni 39 (2) LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale duke bërë pretendimin ankimor se organet administrative kishin bërë vërtetimin e gabur dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke konsideruar se gjendja e saj serioze shëndetësore dhe kishte zbatuar gabimisht të drejtën materiale në dëm të paditësit.*

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës refuzoi të ndajë pensionin invalidor paditësit për shkak se komisioni i mjekëve kishte vlerësuar se paditësi nuk kishte invaliditet të punës.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se vendimi i organit të shkallës së parë dhe të paditurit nuk përmban shënime përkatëse përkitazi me gjendjen faktike dhe provat që mbështesin vërtetimin e kësaj gjendje. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e bazuar.*

A.nr.37/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Osman Tmava dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, procesmbajtëse Ajna Gashi, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit M. H., nga fshati Krushë e Madhe, komuna e Rahovecit, kundër anës së paditur Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale - Këshilli i ankesave për pensionet invalidore Prishtinë, për anulimin e aktvendimit të anës së paditur nr.5000368, datë 4.12.2004, në seancën e mbajtur më 21.03.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

PRANOHET padia.

ANULOHET aktvendimi i Këshillit të ankesave për pensionet e personave me aftësi të kufizuara nr.5000368, datë 4.12.2004.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës nr.5000368 datë 13.07.2004, me të cilin është refuzuar kërkesa që paditësit t'i njihet e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.

Paditësi në padi, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktvendimit të shkallës së dytë, thekson se aktvendimi i anës së paditur është i paligjshëm, se komisionet mjekësore të anës së paditur nuk kanë marrë parasysh faktet se gjendja e tij shëndetësore është e rëndë, se nuk është i aftë për punë dhe se provat e prezantuara nuk i morën parasysh, për çka edhe gjendja faktike nuk u vërtetua në mënyrë të plotë dhe kjo pati për pasojë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në dëm të tij. Ka propozuar që padia të pranohet dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi vlerësoi aktvendimin e kontestuar në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par.1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), gjeti se padia është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë, me vendimin nr.5000368 datë 13.07.2004, e ka refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e së drejtës së pensionit të personave me aftësi të kufizuara. Komisioni mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtruesit të kërkesës, më 26.07.2004 ka nxjerrë përfundimin se aftësia e kufizuar e paditësit është e tillë që ai nuk mund të kryej asnjë punë e cila paguhet, qoftë edhe nëse punon me gjysmë orari.

Në procedurën sipas ankesës, ana e paditur ka siguruar konstatimin dhe mendimin nr.200/3765027, datë 04.12.2004 të Komisionit mjekësor të formuar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i cili komision ka konstatuar se të paditësi nuk ekziston paaftësia, prandaj, ana e paditur me vendimin e kontestuar e ka refuzuar si të pabazuar ankesën.

Nga vendimi i kontestuar del se ky përmban të meta të tilla që e bëjnë të pamundur shqyrtimin e ligjshmërisë së tij.

Gjykata për konfliktin, si rregull, vendos në bazë të fakteve të cilat janë vërtetuar në procedurën administrative. Gjykata Supreme vlerëson se ky konflikt nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative, ngase për faktet e vërtetuara ekzistojnë kundërthënie në shkresat e lëndës. Me vlerësimin e Komisionit mjekësor të datës 26.07.2004 është konstatuar se paditësi, si rezultat i aftësisë së kufizuar, nuk mund të punësohet në asnjë cilësi tani apo në të ardhmen dhe se aftësia e kufizuar është e

përhershme, kushte këto që duhet të plotësohen për t'u gëzuar e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.

Vendimi i kontestuar nuk përmban të dhëna lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të shkallës së parë dhe provat në të cilat është vërtetuar kjo gjendje. Arsyetimi i vendimit të kontestuar nuk përmban arsye përkitazi me thëniet ankimore të paditësit të paraqitura në ankesën e ushtruar kundër aktvendimit të organit të shkallës së parë dhe as në rrjedhën e procedurës së zhvilluar pranë organit të shkallës së dytë.

Të metat e sipërpërmendura janë të natyrës së tillë që nuk mundësojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj me zbatimin e neneve 39 par.2 të LKA, aktvendimi i kontestuar u desh të anulohet.

Në riprocedurë të metat e sipërpërmendura duhet të mënjanohen e pastaj të merret një vendim i ligjshëm.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË  
A.nr.37/2005, datë 21.03.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Vjosa Nimani-Zylfiu

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e pranuar - vendimi i prishur - e drejta për pension invalidor - Neni 1.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr.2000/66/Neni 5.1 i Rregullorës së UNMIK-ut2000/66/ Neni 5.1 të Urdhëresës Administrative 2001/19/ Neni 39 (2) LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale duke bërë pretendimin ankimor se organet administrative kisnin bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke mos konsideruar se shkalla e invaliditetit ishte më e lartë se 40%, si kërkesë për ndarjen e pensionit invalidor.*

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës refuzoi të ndajë pensionin invalidor paditësit. Gjykata Supreme ka vendosur se vendimi i organit të shkallës së parë dhe paditurit përmban dobësi që e bëjnë të pamundshëm shqyrtimin e ligjshmërisë së tij. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e bazuar.*

A.nr.55/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit N. B., nga fshati Bajqinë, komuna e Podujevës, kundër anës së paditur Ministria së Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës për anulimin e aktvendimit të anës së paditur nr.01-02/1178 datë 21.01.2005, në seancën e mbajtur më 21.03.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Pranohet padia.

Anulohet aktvendimi i Departamentit të Mirëqenies Sociale - Administratës Pensionale të Kosovës, Komisioni i Ankesave nr.01-02/1878 datë 21.01.2005.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Departamentit të Mirëqenies Sociale - Administrata Pensionale e Kosovës nr.01-02/1178 datë 14.12.2004, me të cilin është refuzuar kërkesa që paditësit t'i njihet e drejta e pensionit invalidor.

Paditësi me padi, me të cilin konteston ligjshmërinë e aktvendimit të shkallës së dytë thekson se aktvendimi i anës së paditur është i paligjshëm, se komisionet mjekësore të anës së paditur gabimisht kanë vlerësuar shkallën e invaliditetit, për arsye se nuk i kanë marrë parasysh faktet se gjendja shëndetësore e tij është e rëndë dhe se shkalla e invaliditetit të tij është më e lartë se 40%. Duke mos ia marrë parasysh provat të cilat ai i ka prezantuar konsideron se edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe se kjo ka pasur për pasojë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në dëm të tij. Ka propozuar që padia të pranohet dhe të anulohet aktvendimi i kontestuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi vlerësoi aktvendimin e kontestuar në përputhje me dispozitën e parashikuar me nenin 40 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se padia është e bazuar.

Me dispozitën e nenit 1.1 të Rregullores nr.2000/66 "Për beneficionet e invalidëve të Kosovës dhe për më të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë", invalid i luftës konsiderohet çdo person që ka marrë plagë fizike si pasojë e drejtëpërdrejtë e konfliktit të armatosur në Kosovë, niveli minimal i lëndimit të të cilit përkufizohet me anë të një urdhërese administrative të lëshuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Në nenin 2.1 të Udhëzimit Administrativ nr.2001/9 "Për plotësimin e rregullores nr.2000/66 për beneficionet e invalidëve të luftës të Kosovës dhe për më të afërmit e tyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë", parashikohet se pagesa për ivalidët e luftës do të kryhen varësisht nga niveli i aftësisë së tyre fizike të konstatuar nga Komisioni Qendror Mjekësor në bazë të shkallëve vijuese të pagesës: a) 70-100% paaftësi fizike: shkalla e parë e pagesës dhe b) 40-69% paaftësi fizike: shkalla e dytë e pagesës, ndërsa në nenin 2.2 parashikohet se nuk do të marrin kurrfarë ndihmash personat me nivel të paaftësisë fizike më pak se 40%.

Me dispozitën e nenit 5.1 të Rregullores nr.2000/66, invalidët që parashtrajnë kërkesën për ndihma sipas kësaj Rregulloreje, kanë të drejtën e kërimit të rishqyrtimit të vendimeve administrative të bëra nga Komisioni Qendror Mjekësor në lidhje me të drejtën e shfrytëzimit dhe shkallën e së drejtës së shfrytëzimit të një ndihme të tillë. Sipas nenit 5.1 të Udhëzimit Administrativ 2001/19 për plotësimin e Rregullores nr.2000/66, rishikimin e

bën një nëpunës i lartë për ankesa dhe së paku dy persona të tjerë të cilët nuk kanë qenë të përfshirë drejtpërsëdrejti në përpunimin e kërkesës.

Nga aktvendimi i organit të shkallës së parë nuk mund të kuptohet se kush ka marrë pjesë në nxjerrjen e vendimit, ashtu siç nuk mund të kuptohet as nga aktvendimi i kontesutar se kush e ka bërë rishikimin e aktvendimit të organit të shkallës së parë, prandaj nuk mund të vlerësohet se është respektuar dispozita e nenit 5.1 e Udhëzimit Administrativ nr.2001/19 por, nuk mund të kuptohet dhe se kush ka qenë anëtarë të Komisionit Qendror Shëndetësor dhe kush i Komisionit që ka vendosur lidhur me ankesën për rishqyrtim. Në të dy formularët janë nënshkrimet e personave të njëjtë.

Vendimi i kontestuar nuk përmban të dhëna lidhur me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të shkallës së parë dhe provat në të cilat është vërtetuar kjo gjendje. Arsyetimi i vendimit të kontestuar nuk përmban arsye përkitazi me thëniet ankimore të paditësit të paraqitura në ankesën e ushtruar kundër aktvendimit të organit të shkallës së parë dhe as në rrjedhën e procedurës së zhvilluar pranë organit të shkallës së dytë.

Nga vendimi i kontestuar del se ky përmban të meta të tilla që e bëjnë të pamundur shqyrtimin e ligjshmërisë së tij.

Të metat e sipërpërmendura janë të natyrës së tillë që nuk mundësojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj me zbatimin e neneve 39 par.2 të LKA, aktvendimi i kontestuar u desh të anulohet.

Në riprocedurë të metat e sipërpërmendura duhet të mënjanohen e pastaj të merret një vendim i ligjshëm.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË  
A.nr.55/2005, datë 21.03.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e hedhur poshtë - e drejta për ndihmë sociale - Neni 40 (1) LKA/ Neni 42 (2) LKA/ Neni 4 pika 1 e Rregullores së UNMIK-ut Nr.2003/38]**

*Paditësit paraqiti ankesë kundër aktvendimit të Këshillit për Ankesa pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në rastet e ndihmës sociale duke bërë pretendimin ankimor se organet administrative kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishin bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke mos konsideruar se ajo jeton nën kushte tejet të vështira ekonomike. Këshillit për Ankesa pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në rastet e ndihmës sociale duke bërë pretendimin ankimor se organet administrative kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale dhe kishin bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke mos konsideruar gjendjen e tij të rëndë shëndetësore dhe faktin se ai nuk ishte i aftë për punë.*

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale refuzoi të ndajë pensionin invalidor për shkak se komisioni i mjekëve vlerësoi se paditësi nuk kishte invaliditet të plotë dhe të përhershëm.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës së parë dhe të dytë kishin zbatuar drejtë ligjin dhe kishin bërë vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike duke gjetur se paditësi nuk kishte përmbushur kërkesat për ndarjen e pensionit invalidor, siç parashikohet me nenin 3 të Ligjit për Pensionin Invalidor. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë*

A.nr.67/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Osman Tmava dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, procesmbajtëse Ajna Gashi, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit V. Q., nga Sharri-Dragashi, kundër anës së paditur Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale - Këshilli i ankesave për pensionet invalidore Prishtinë, për anulimin e aktvendimit të anës së paditur nr.5008633 datë 18.12.2004, në seancën e mbajtur më 30.03.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet padia.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, e paraqitur kundër aktvendimit të Departamentit të Administratës Pensionale të Kosovës nr.5008633 datë 13.07.2004, me të cilin është refuzuar kërkesa që paditësit t'i njihet e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.

Paditësi në padi, me të cilën konteston ligjshmërinë e aktvendimit të shkallës së dytë, thekson se aktvendimi i anës së paditur është i paligjshëm, se komisionet mjekësore të anës së paditur nuk kanë marrë parasysh faktet se gjendja e tij shëndetësore është e rëndë, se nuk është i aftë për punë dhe se provat e prezantuara nuk i morën parasysh, për çka edhe gjendja faktike nuk u vërtetua në mënyrë të plotë dhe kjo pati për pasojë zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në dëm të tij. Ka propozuar që padia të pranohet dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi vlerësoi aktvendimin e kontestuar në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par.1 të Ligjit për Kontestet Administrative (LKA), gjeti se padia nuk është e bazuar.

Gjykata për konfliktin, si rregull, vendos në bazë të fakteve të cilat janë vërtetuar në procedurën administrative.

Nga shkresat e lëndës shihet se organi i shkallës së parë me vendimin nr.5008633 datë 13.07.2004 ka refuzuar kërkesën e paditësit për njohjen e së drejtës së pensionit të personave me aftësi të kufizuara, për arsye se Komisioni mjekësor, i cili e ka vlerësuar aftësinë e kufizuar të ushtruesit të kërkesës, më 04.10.2004 ka nxjerrë përfundimin se të paditësi nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme.

Me dispozitën e nenit 1.5 të Ligjit nr.2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë, i shpallur me Rregulloren nr.2003/40, parashikohet se një person do të konsiderohet se është me aftësi të përherë dhe plotësisht të kufizuara, nëse ka moshën më shumë se 18 vjeç dhe më pak se 65 vjeç dhe ka diagnozën mjekësore për gjendjen fizike, ndijore ose mendore, ka sëmundje ose aftësi të kufizuar që e bëjnë atë të paaftë për çfarëdo pune që shpërblehet dhe kur Ministria bën vlerësimin e personit dhe vendos se ai i përmbush kriteret e parashikuara në këtë ligj. Për të gëzuar të drejtën e pensionit të personave me aftësi të kufizuara, gjendja shëndetësore, sëmundja apo aftësia e kufizuar duhet të tregojë se personi në kohën kur paraqet kërkesën, është plotësisht i paaftë për çfarëdo pune që shpërblehet në të ardhmen. Fillimi i përkeqësimit të gjendjes shëndetësore, sëmundjes apo aftësisë së kufizuar duhet të jetë paraqitur më së paku një vit para datës së dorëzimit të kërkesës.

Në procedurën sipas ankesës, ana e paditur ka siguruar konstatimin dhe mendimin nr.100/0771062, datë 18.12.2004 të Komisionit mjekësor të

formuar nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenie Sociale e në përputhje me nenin 2.2 të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kurizuara në Kosovë, i cili Komision pajtohet me vlerësimin e Komisionit mjekësor të dhënë më datën 4.10.2004, prandaj, ana e paditur me vendimin e kontestuar e ka refuzuar si të pabazuar ankesën.

Gjykata Supreme ka gjetur se duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, organi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë kanë zbatuar drejt dispozitat e procedurës së përgjithshme administrative dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se paditësi nuk i ka përmbushur kriteret e parashikuara me nenin 3 të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë për t'iu njohur e drejta e pensionit për persona me aftësi të kufizuara.

Nga sa u tha më lart, Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me nenin 42 par.1 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË  
A.nr.67/2005, datë 30.03.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Vjosa Nimani-Zylfiu

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ- pezullimi i procedurës]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale duke bërë pretendimin ankimor se organet administrative kishin bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe kishte zbatuar gabimisht gjendjen faktike duke mos konsideruar gjendjen e tij të rëndë shëndetësore dhe faktin se ai nuk është i aftë për punë. Më tutje, paditësi informoi gjykatën për tërheqjen e kërkesëpadinë. Prandaj, Gjykata Supreme vendosi të pezullojë procedurën.*

A.nr.106/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani Zylfiu, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditëses N. R., nga fshati Rogaqicë, Komuna e Kamenicës, kundër aktvendimit të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Këshilli i ankesave për pensionet invalidore - Prishtinë, nr.5006363 datë 16.12.2004, në lëndën e pensionit invalidor, në seancën e mbajtur më 21.03.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pezullohet procedura.

A r s y e t i m i

Paditësja me padinë e paraqitur konteston ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar të paditurës sepse e paditura nuk ka marrë parasysh faktet se gjendja shëndetësore e saj është e rëndë, se nuk është e aftë për punë, se provat e prezantuara nuk u morën parasysh, për cka edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të plotë kjo si pasojë kishte zbatimin e gabuar të së drejtës materiale në dëm të saj. Ka propozuar që padia të pranohet dhe të anulohet vendimi i kontestuar.

Paditësja me parashtrësën e datës 28.02.2005 e informon këtë Gjykatë se e tërheq padinë.

Për këtë arsye Gjykata duke mos u lëshuar në vendosje sipas padisë, në bazë të nenit 28 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.nr.106/2005, datë 21.03.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i Kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ procedura e pezulluar - kriteret për pranimin e të drejtës për ndihmë sociale - Rregullorja e UNMIK-ut2003/28/ Neni 28 LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit duke bërë pretendimin ankimor se organi i mësipërm kishte shkelur ligjin duke dëmtuar paditësin nëpërmjet të shqiptimit të masës së vërejtjes së fundit para marrjes së licencës.*

*Mëtutjue, paditësi informoi gjykatën për tërheqjen e kërkesëpadinë. Prandaj, Gjykata Supreme vendosi të pezullojë procedurën.*

A.nr.132/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Vjosa Nimani Zylfiu dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit Qendra për Kontrollimin Teknik të Automjeteve "QMI" në Lipjan, të cilën e përfaqëson A. T., kundër aktvendimit të Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit në Prishtinë, Nr.MTPT-KA-01/05 datë 24.01.2005, në lëndën për kompensim të dëmit të shkaktuar për shkak të ndërprerjes së punës, në seancën jopublike të mbajtur me datën 19.04.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pezullohet procedura.

A r s y e t i m i

Paditësi me padinë e paraqitur ka theksuar se Ministria e Transportit dhe Postelekomunikacionit në Prishtinë, me aktvendimin Nr.MTPT/ZM-ka-01/05, të datës 24.01.2005, i ka shqiptuar masën - Vërejtje e fundit para marrjes së licencës, me çka dhe i është shkaktuar dëm sepse përkohësisht i është ndërpre puna në periudhën prej 31.12.2004 e gjer me datën 24.01.2005. Pretendon se aktvendimi i kontestuar është marrë në kundërshtim me ligjin dhe propozon që padia të aprovohet dhe aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Paditësi me parashtrësën e datës 01.04.05 e informoi këtë Gjykatë se e tërheq padinë.

Për këtë arsye Gjykata duke mos u lëshuar në vendosje sipas padisë, në bazë të nenit 28 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.nr.132/2005, datë 19.04.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i Kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e pranuar - vendimi i prishur Neni 33 (3) LKA/Neni 62 LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të doganave të UNMIK-ut në Prishtinë duke bërë pretendimin ankimor se autoriteti i lartëpërmendur kishin kishite bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke mos konsideruar faktin që ai është në gjendje të vështirë materiale..  
Gjykata Supreme ka vendosur të pranojë padinë për shkak se pala e paditur nuk ka referuar shkresat e lëndës. Prandaj, Gjykata Supreme vendosi ta pranojë ankesën*

A.nr.142/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë të paditësit NPT "Riza Company" nga Prishtina, kundër aktvendimit të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut në Prishtinë, 01.nr.2201 datë 19.10.2004, në lëndën e rishqyrtimit të bazës doganore, në seancën e mbajtur me datën 20.06.2005, mori:

**A K T G J Y K I M**

Aprovohet padia.

Anulohet aktvendimi i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut në Prishtinë, 01.nr.2201 datë 19.10.2004.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e bazës doganore për mallin: korniza për syze, të paraqitur për goganim sipas dokumentit unik doganor nr. 042011000001660 datë 08.10.2004, DD Aeroporti.

Paditësi me padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar,

për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, duke pohuar se nuk ka kurrfarë të ardhurash dhe jeton në gjendje të vështirë ekonomike. Propozon që padia të aprovohet dhe të anulohet aktvendimi i kontestuar.

Për të shqyrtuar çështjen kontestuese e cila është lëndë e kontestit administrativ, Gjykata me këkesën A.nr.142/2005 datë 17.03.2005, ka kërkuar nga organi i paditur që t'i dërgojë shkresat e lëndës dhe përgjigjen në padi. Organi i paditur pasi nuk veprim sipas kërkesës së parë dhe as pas kërkesës së dytë të Gjykatës, të datës 30.5.2005, Gjykata Supreme për këto arsye në vështrim të nenit 33 par.3 të Ligjit mbi Kontestet Administrative, vendosi kontestin pa shkresa të lëndës.

Meqë në padi kontestohet aktvendimi i organit të paditur për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata nuk ka mundësi t'i vlerësojë pretendimet e padisë dhe ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar për shkak se organi i paditur nuk i ka dërguar shkresat e lëndës, e aprovon padinë dhe anulon aktvendimin e kontestuar.

Në vështrim të nenit 62 të LKA, organi i paditur është i obliguar që në përmbartimin e aktgjykimit të merr aktvendim të ri.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.nr.142/2005, datë 20.06.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e hedhur poshtë - e drejta për ndihmë sociale - Neni 40 (1) LKA/ Neni 42 (2) LKA/ Neni 4 pika 1 e Rregullorës së UNMIK-ut Nr.2003/38]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Këshillit të Ankesave pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale duke bërë pretendimin ankimor se organet administrative kishin bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale duke mos konsideruar faktin se ai nuk ishte i aftë për punë.*

*Qendra për Punë Sociale në Prizren ndërpreu ndarjen e ndihmës sociale për familjen e paditësit për shkak se nuk kanë përmbushur kërkesat për ndarjen e saj.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se organi i shkallës së parë dhe të dytë kishte zbatuar drejtë ligjin dhe kishte bërë vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike kur ka gjetur se familja e paditësit nuk plotëson kërkesat për ndarjen e ndihmës siç parashikohet me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/28 mbi Skemën e Ndihmës Sociale. Gjykata Supreme ka vendosur se i padituri duke marrë vendimin e kundërshtuar kishte pranuar plotësisht gjendjen faktike. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë.*

A.nr.170/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Osman Tmava dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, procesmbajtëse Ajna Gashi, bashkëpunëtore profesionale, lidhur me kontestin administrativ sipas padisë së paditësit I. M., nga fshati Kushin Has, Komuna e Prizrenit, kundër anës së paditur Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale - Komisioni për Ankesa Prishtinë nr.02/1233 datë 09.07.2004, në lëndën e ndihmës sociale, në seancën jopublike të Kolegjit të mbajtur me datë 17.05.2005, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet padia.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, paraqitur kundër aktvendimit të Qendrës për Punë Sociale në Prizren nr.001318/1 datë 05.03.2004, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i organit të shkallës së parë, me të cilin paditësit i është ndërprerë e drejta e ndihmës sociale për arsye se familja e paditësit nuk paraqet rast social.

Paditësi me padi konteston aktvendimin e goditur, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke pohuar se ai është i aftë për punë dhe veprimtari ekonomike, gjendje kjo e cila dëshmohet me vendimin e Administratës Pensionale të Kosovës, me të cilin i njihet pensioni sipas skemës për persona me aftësi të kufizuar. Propozon që padia të aprovet e aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Ana e paditur nuk ka paraqitur përgjigje në padi.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në drejtim të pretendimeve të padisë dhe, në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Padia është e pabazuar.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndhmës Sociale, në nenin 4 pika 1 parashikon se, për të fituar të drejtën e ndihmës sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive vijuese:

(a) kategoria e parë e cila në bazë të nenit 2 pika 7 të rregullores nënkupton familjen në të cilën të gjithë anëtarët janë të varur dhe njeri prej tyre nuk është i punësuar

(b) kategoria e dytë - familja e cila ka një anëtar të aftë për punë dhe të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare apo që nën përkujdesje ka një jetim nën moshën 15 vjeçare ose të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë të varur sipas përkufizimit të nenit 2.7 të Rregullores së sipërpërmendur ose të jenë të regjistruar si të papunësuar në Zyrat e Punësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Nga shkresat e lëndës shihet se, organet administrative në procedurën e zhvilluar administrative, me rastin e verifikimit se a i përmbushë paditësi kushtet për të fituar të drejtën e ndihmës sociale të parashikuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndhmës Sociale, kanë konstatuar se familja e paditësit nuk i plotëson kriteret e parashikuara në skemën e lartpërmendur për të përfituar ndihmën sociale.

Ana e paditur, në procedurën sipas ankesës, me aktvendimin e kontestuar e ka pranuar në tërësi gjendjen faktike dhe qëndrimin juridik të organit të shkallës së parë dhe, duke pasur parasysh se familja e tij ka fëmijë të moshës madhore të aftë për punë dhe veprimtari ekonomike si djali B. dhe vajzën M., dhe bashkëshorten N., njëherit, në bazë të vendimit nr.5015656 datë 31.12.2004, rezulton se paditësit i është miratuar kërkesa për pensionin e personave me aftësi të kufizuar, prandaj, ka refuzuar ankesën dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e kundërshtuar.

Gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative është vërtetuar drejt gjendja faktike, nuk është cënuar ligji në dëm të paditësit, kështu që, në përputhje me nenin 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.nr.170/2005, datë 17.05.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetari i kolegjit,  
Vjosa Nimani-Zylfiu

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - ankesa e pranuar - vendimi prishur - Neni 33 (3) LKA/Neni 62 LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke mos konsideruar se si ishte në gjendje të vështirë ekonomike dhe se nuk kishte të ardhura.*

*Administrata tatimore e Kosovës e obligoi paditësin të paguajë tatimin mbi vlerën e paragjykuar dhe tatimin në të ardhura.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte pranuar për shkak se i padituri nuk kishte vepruar sipas kërkesës së gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë për dorëzimin e shkresave të lëndës dhe dhënies së përgjigjes në kërkesëpadi. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pranueshme dhe urdhëroi të paditurin të nxjerrë një vendim të ri.*

A.nr.174/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Meleqe Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë të paditësit NTSH "Nikolla-As" me seli në fshatin Qerim Komuna e Gjakovës, kundër aktvendimit të Bordit të pavarur për rishqyrtime në Prishtinë, A.nr.21/2005 datë 07.02.2005, në lëndën e tatimit, në seancën e mbajtur me datën 20.06.2005, mori:

**A K T G J Y K I M**

Aprovohet padia.

Anulohet aktvendimi i Bordit të pavarur për rishqyrtime në Prishtinë, A.nr.21/2005 datë 07.02.2005.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar ankesa e paditësit kundër vendimit të Departamentit të ankesave të Administratës tatimore të Kosovës në Prishtinë nr.333 datë 26.10.2004, me të cilin paditësi mbetet detyruar për pagimin e tatimit të paragjykuar, tatimit në vlerën e shtuar dhe tatimi në paga.

Paditësi me padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, duke pohuar se nuk ka kurrfarë të ardhurash dhe jeton në gjendje të vështirë ekonomike. Propozon që padia të aprovohet dhe të anulohet aktvendimi i kontestuar.

Për të shqyrtuar çështjen kontestuese e cila është lëndë e kontestit administrativ, Gjykata me kërkesën A.nr.174/2005 datë 21.03.2005, ka kërkuar nga organi i paditur që t'i dërgojë shkresat e lëndës dhe përgjigjen në padi. Organi i paditur pasi nuk veproi sipas kërkesës së parë dhe as pas kërkesës së dytë të Gjykatës, të datës 30.5.2005, Gjykata Supreme për këto arsye në vështrim të nenit 33 par.3 të Ligjit mbi Kontestet Administrative, vendosi kontestin pa shkresa të lëndës.

Meqë në padi kontestohet aktvendimi i organit të paditur për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata nuk ka mundësi t'i vlerësojë pretendimet e padisë dhe ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar për shkak se organi i paditur nuk i ka dërguar shkresat e lëndës, e aprovon padinë dhe anulon aktvendimin e kontestuar.

Në vështrim të nenit 62 të LKA, organi i paditur është i obliguar që në përmbarrimin e aktgjykimit të merr aktvendim të ri.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.nr.174/2005, datë 20.06.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e pranuar - vendimi i prishur - Neni 33 (3) LKA/Neni 62 LKA]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës duke bërë pretendimin ankimor se organi i sipërpërmendur kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke mos konsideruar se si ishte në gjendje të vështirë ekonomike dhe se nuk kishte të ardhura.*

*Administrata tatimore e Kosovës e obligoi paditësin të paguajë tatimin mbi vlerën e paragjykuar dhe tatimin në të ardhura.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte pranuar për shkak se i padituri nuk kishte vepruar sipas kërkesës së gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë për dorëzimin e shkresave të lëndës dhe dhënies së përgjigjes në kërkesëpadi. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pranueshme dhe urdhëroi të paditurin të nxjerrë një vendim të ri.*

A.nr.183/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Meleq Behxheti dhe Vjosa Nimani-Zylfiu, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë të paditësit NTP "Integral Company" me seli në Ferizaj, kundër aktvendimit të Bordit të pavarur për rishqyrtime në Prishtinë, A.nr.28/2005 datë 14.02.2005, në lëndën e tatimit, në seancën e mbajtur me datën 20.06.2005, mori:

**A K T G J Y K I M**

Aprovohet padia.

Anulohet aktvendimi i Bordit të pavarur për rishqyrtime në Prishtinë, A.nr.28/2005 datë 14.02.2005.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar ankesa e paditësit kundër vendimit të Departamentit të ankesave të Administratës tatimore të Kosovës në Prishtinë nr.331 datë 26.10.2004, me të cilin paditësi mbetet detyrues për pagimin e tatimit të paragjykuar, tatimit në vlerën e shtuar dhe tatimi në fitim.

Paditësi me padi konteston ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, duke pohuar se nuk ka kurrfarë të ardhurash dhe jeton në gjendje të vështirë ekonomike. Propozon që padia të aprovohet dhe të anulohet aktvendimi i kontestuar.

Për të shqyrtuar çështjen kontestuese e cila është lëndë e kontestit administrativ, Gjykata me kërkesën A.nr.183/2005 datë 25.03.2005, ka kërkuar nga organi i paditur që t'i dërgojë shkresat e lëndës dhe përgjigjen në padi. Organi i paditur pasi nuk veproi sipas kërkesës së parë dhe as pas kërkesës së dytë të Gjykatës, të datës 30.5.2005, Gjykata Supreme për këto arsye në vështrim të nenit 33 par.3 të Ligjit mbi Kontestet Administrative, vendosi kontestin pa shkresa të lëndës.

Meqë në padi kontestohet aktvendimi i organit të paditur për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, Gjykata nuk ka mundësi t'i vlerësojë pretendimet e padisë dhe ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar për shkak se organi i paditur nuk i ka dërguar shkresat e lëndës, e aprovon padinë dhe anulon aktvendimin e kontestuar.

Në vështrim të nenit 62 të LKA, organi i paditur është i obliguar që në përmbarrimin e aktgjykimit të merr aktvendim të ri.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

A.nr.183/2005, datë 20.06.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna GashiKryetar i kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e pranuar - vendimi i prishur- e drejta për ndihmë sociale - Neni 40 (1)LKA/ Neni 39 (2)/ LKA/ Neni 42 (2) LKA/ Neni 4 pika 1 e Rregullorës së UNMIK-utNr.2003/38]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Këshillit të Ankesave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale duke bërë pretendimin ankimor se organi i shkallës së parë dhe të dytë kishte bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke mos konsideruar gjendjen e tij shëndetësore dhe faktin se ai nuk ishte i aftë të punojë dhe se jetonte në kushte tejet të vështira.*

*Qendra për Punë Sociale në Pejë ndërpreu ndihmën sociale për familjen e paditësit për shkak se ajo nuk plotëson kërkesat për ndarjen e kësaj ndihme.*

*Gjykata Supreme ka vendosur se kjo çështje administrative përmban kundërshtime të cilat nuk janë eliminuar nga organi i shkallës së parë dhe i padituri. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e bazuar.*

A.nr.196/2005

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - Kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vjosa Nimani-Zylfiu, kryetare, Osman Tmava dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, me bashkëpunëtoreshen profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit Sh. M., nga fshati Loxhë, komuna e Pejës, kundër anës së paditur Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale - Komisioni për Ankesa për anulimin e aktvendimit nr.380 datë 25.02.2005, në lëndën e ndihmës sociale, në seancën jopublike të kolegjit të mbajtur me datë 17.05.2005, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

Aprovohet padia.

Anulohet aktvendimi i Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale-Komisioni për Ankesa Prishtinë nr.380 datë 25.02.2005

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e kontestuar është refuzuar ankesa e paditësit paraqitur kundër aktvendimit të Qendrës për Punë Sociale Pejë nr.17-02287 datë 17.02.2004, me të cilin është vërtetuar aktvendimi i organit të shkallës së parë, me të cilin paditësit i është ndërprerë e drejta e ndihmës sociale për arsye se familja e paditësit nuk paraqet rast social.

Paditësi me padi konteston aktvendimin e goditur, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke pohuar se ai është në gjendje të rëndë shëndetësore, i paaftë për punë, familja e tij numëron tetë anëtarë, jeton në shtëpi dy dhomëshe ku që të dy dhomat janë pa dyer, në kushte të rënda ekonomike pa kurfar burimi të të ardhurave. Propozon që padia të aprovohet e aktvendimi i kontestuar të anulohet.

Ana e paditur nuk ka dhënë përgjigje në padi.

Gjykata Supreme e Kosovës, pasi vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në drejtim të pretendimeve të padisë dhe në përputhje me dispozitën e parashikuar nga neni 40 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Padia është e bazuar.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2003/28 datë 18 gusht 2003, për Skemën e Ndihmës Sociale, me nenin 4 pika 1 parasheh se, për të fituar të drejtën e ndihmës sociale, të gjithë anëtarët e familjes duhet të jenë banorë të përhershëm të Kosovës dhe t'i plotësojnë kushtet për kategorizim në njërin prej kategorive vijuese:

(a) kategoria e parë e cila në bazë të nenit 2 pika 7 të rregullores nënkupton familjen në të cilën të gjithë anëtarët janë të varur dhe njeri prej tyre nuk është i punësuar

(b) kategoria e dytë - familja e cila ka një anëtar të aftë për punë dhe të paktën një fëmijë nën moshën 5 vjeçare apo që nën përkujdesje ka një jetim nën moshën 15 vjeçare ose duhet të jenë të varur sipas përkufizimit të nenit 2.7 të Rregullores së sipër cekur ose të jenë të regjistruar si të papunësuar në Zyrat e Punësimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Nga shkresat e lëndës del se, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, sipas ankesës i ka pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të Qendrës për Punë Sociale, ka refuzuar ankesën dhe ka lënë në fuqi aktvendimin e ankimuar, kështu që vendimin e tyre e bazojnë në atë se paditësi është shpallë i aftë për punë nga komisioni regjional mjekësor dhe se nuk ka fëmijë nën moshën pesë vjeçare.

Gjykata konkludon se në këtë çështje administrative ekzistojnë

kundërthënie të cilat nuk janë evituar nga ana e organit të shkallës së parë dhe atij të paditur, sepse sipas verifikimit të gjendjes faktike të bërë nga ekipi verifikues pa datë shënohet se familja i plotëson kriteret për ndihmë sociale.

Nga këto arsye, Gjykata konstaton që me aktvendimin e kontestuar është cënuar Ligji në dëm të paditësit, sepse është marrur pa u vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha provat relevante në lëndë, që do të thotë në gjendje të pavërtetuar faktike, duke mos u evituar kontradiktoriteti në mes të raportit verifikues në teren në të cilin rezultoi se paditësi i plotëson kriteret e ndihmës sociale dhe faktit se paditësi në bazë të komisionit regional mjekësor është shpallë i aftë për punë dhe veprimtari ekonomike e që nuk ka fëmijë nën moshën pesë vjeçare, lidhur me të drejtën e kërkuar nga e cila është refuzuar.

Në këtë drejtim, Gjykata e obligon organin e paditur që në riprocedurë t'i vlerësojë provat e administruara në lëndë, provat e prezantuara, e në rast nevoje, do të nxjerrë edhe prova të tjera, të cilat do të ndikonin në vendosjen e drejtë dhe të ligjshme të kësaj çështje administrative.

Nga sa u cek më lartë, Gjykata në vështrim të nenit 39 par.2 dhe nenit 42 par.2 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

A.nr.196/2005, datë 17.05.2005

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Ajna Gashi, procesmbajtëse,

Kryetari i kolegjit,  
Vjosa Nimani-Zylfiu

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e hedhur poshtë - lënda e përcjellur Gjykatës Komunale kompetente- Neni 9 (1) pika 2 LKA/ Neni 26 (1) pika 7 LGJR/ Neni 65 LPK/ Neni 11.6 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë dhe Bordit të Pavarur Mbikëqyrës të Ministrisë së Shërbimeve Publike.*

*Kuvendi Komunal i Vushtrrisë shkarkoi paditësin nga detyra e drejtorit të Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.*

*Gjykata Supreme vendosi se kërkesëpadia nuk mund të paraqitet në këtë rast dhe se në bazë të nenit 26 (1) pika 7 e Ligjit për Gjykatat e Rregullta dhe nenit 65 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore ky contest i punës bie në kuadër të kompetencës lëndore të gjykatës komunale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur ankesa e paditësit ishte e pabazë dhe i'a përcjelli lëndën Gjykatës Komunale në Vushtri.*

A.nr.381/2005

#### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, me bashkëpunëtoresh profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit B. J. Rr."Avni Rustemi" nr.x nga Vushtria, kundër vendimit të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë 01.Nr.47/05 datë 14 janar 2005, të datës në lëndën nga marrëdhënia e punës, për shkak të heshitjes së administratës, në seancën jopublike të mbajtur me datën 01.06.2005, mori këtë:

#### A K T V E N D I M

Hidhet poshtë padia.

Lënda t'i dërgohet Gjykatës Komunale në Vushtri, si Gjykatë kompetente.

#### A r s y e t i m i

Paditësi me padi ka theksuar se me vendimin e Kuvendit Komunal të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.47/2005 datë 14.01.2005, është shkarkuar nga posti i Drejtorit të Drejtorisë për shëndetësi dhe përkujdesje sociale në Vushtri,

se me datën 11.02.2005, ankesë i ka paraqitur Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike në Prishtinë e cila nuk ka vendosur për ankesën edhe me kalimin e afatit prej 90 ditëve, për çka me padi kërkon që të anulohet vendimi i kontestuar të detyrohet e paditura të e kthej në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Gjykata konstaton se në këtë çështje padia nuk është e lejuar.

Në nenin 9 par.1 pika 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" nr.4/1977), parashihet se nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ kundër akteve të marrura në çështjet për të cilat në bazë të dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/36 datë 22.12.2001, në nenin 11.6 parashihet se asgjë nuk mund të pengojë të drejtën e një nënpunësi civil për shqyrtimin procedural të vendimit përfundimtar administrativ në pajtim me ligjin në fuqi.

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta ("Gaz.zyr.e RSFJ" nr.21/1978), në nenin 26 par.1 pika 7 parashihet kompetencën reale të Gjykatës Komunale për të gjykuar kontestet nga marrëdhënia e punës.

Në këtë drejtim Ligji i Procedurës Kontestimore ("Gaz. Zyr.e RSFJ" nr.4/1977) në nenin 65 parashihet se në kontestin nga marrëdhënia e punës nëse paditësi është i punësuar - punëtorë, për gjykim është kompetente përpos Gjykatës që ka kompetencë të përgjithshme për të paditurin edhe Gjykata në territorin e së cilës kryhet apo është kryer puna respektivisht Gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi i kontestuar dhe procedura e cila i ka paraprirë marrjes së atij vendimi nuk e kanë karakterin e aktit dhe procedurës administrative si parashihet me nenin 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative e duke pasur parasysh dispozitat e ligjeve të caktuara më lartë, gjen se kompetente për të vendosur këtë kontest është Gjykata Komunale në Vushtri dhe për këto arsye padinë e hudhi poshtë si të palejuar, në vështrim të nenit 30 par.1 pika 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

A.nr.381/2005, datë 01.06.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i Kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e hedhur poshtë - lënda e përcjellur Gjykatës Komunale kompetente - Neni 9 (1) pika 2 LKA/ Neni 26 (1) pika 7 LGJR/ Neni 65 LPK/ Neni 11.6 i Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/36]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë dhe Bordit të Pavarur Mbikëqyrës të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Kuvendi Komunal i Vushtrrisë shkarkoi paditësin nga detyra e drejtorit të Departamentit të Gjeodezisë, Kadastrit dhe Marrëdhënieve Pronësoro-Juridike.*

*Gjykata Supreme vendosi se kërkesëpadia nuk mund të paraqitet në këtë rast dhe se në bazë të nenit 26 (1) pika 7 e Ligjit për Gjykatat e Rregullta dhe nenit 65 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore ky kontest i punës bie në kuadër të kompetencës lëndore të gjykatës komunale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë dhe i'a përcjelli lëndën Gjykatës Komunale në Vushtri.*

A.nr.382/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit B. Xh., Rr."Bahri Kuqi" nga Vushtria, kundër vendimit të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, 01.Nr.49/2005 të datës 14.01.2005, për shkak të heshtjes së administratës, në seancën jopublike të mbajtur me datën 01.06.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hidhet poshtë padia.

Lënda t'i dërgohet Gjykatës Komunale në Vushtri, si Gjykatë kompetente.

A r s y e t i m i

Paditësi me padi ka theksuar se me vendimin e Kuvendit Komunal të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.49/2005 datë 14.01.2005, është shkarkuar nga posti i Drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe marrëdhënie

pronësoro juridike në Vushtri, se me datën 09.02.2005, ankesë i ka paraqitur Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike në Prishtinë e cila nuk ka vendosur për ankesën edhe me kalimin e afatit prej 90 ditëve, për çka me padi kërkon që të anulohet vendimi i kontestuar të detyrohet e paditura të e kthej në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Gjykata konstaton se në këtë çështje padia nuk është e lejuar.

Në nenin 9 par.1 pika 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" nr.4/1977), parashihet se nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ kundër akteve të marrura në çështjet për të cilat në bazë të dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/36 datë 22.12.2001, në nenin 11.6 parasheh se asgjë nuk mund të pengojë të drejtën e një nënpunësi civil për shqyrtimin procedural të vendimit përfundimtar administrativ në pajtim me ligjin në fuqi.

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta ("Gaz.zyr.e RSFJ" nr.21/1978), në nenin 26 par.1 pika 7 parasheh kompetencën reale të Gjykatës Komunale për të gjykuar kontestet nga marrëdhënia e punës.

Në këtë drejtim Ligji i Procedurës Kontestimore ("Gaz. Zyr.e RSFJ" nr.4/1977) në nenin 65 parasheh se në kontestin nga marrëdhënia e punës nëse paditësi është i punësuar - punëtorë, për gjykim është kompetente përpos Gjykatës që ka kompetencë të përgjithshme për të paditurin edhe Gjykata në territorin e së cilës kryhet apo është kryer puna respektivisht Gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi i kontestuar dhe procedura e cila i ka paraprirë marrjes së atij vendimi nuk e kanë karakterin e aktit dhe procedurës administrative si parashihet me nenin 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative e duke pasur parasysh dispozitat e ligjeve të caktuara më lartë, gjen se kompetente për të vendosur këtë kontest është Gjykata Komunale në Vushtri dhe për këto arsye padinë e hudhi poshtë si të palejuar, në vështrim të nenit 30 par.1 pika 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.nr.382/2005, datë 01.06.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i Kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e hedhur poshtë - lënda e përcjellur Gjykatës Komunale kompetente- Neni 9 (1) pika 2 LKA/Neni 26 (1) pika 7 LGJR/ Neni 65 LPK/Neni 30 (1) pika 5 LKA/Neni 11.6 i Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/36]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë dhe Bordit të Pavarur Mbikëqyrës të Ministrisë së Shërbimeve Publike.*

*Kuvendi Komunal i Vushtrrisë shkarkoi paditësin nga detyra e drejtorit të Departamentit të Bujqësisë dhe Burimeve Natyrore.*

*Gjykata Supreme vendosi se kërkesëpadia nuk mund të paraqitet në këtë rast dhe se në bazë të nenit 26 (1) pika 7 e Ligjit për Gjykatat e Rregullta dhe nenit 65 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore ky kontest i punës bie në kuadër të kompetencës lëndore të gjykatës komunale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë dhe i'a përcjelli lëndën Gjykatës Komunale në Vushtri.*

A.nr.383/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit H. S., nga Vushtria, kundër vendimit të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë 01.Nr.50/05 datë 14.01.2005, për shkak të heshtjes së administratës, në seancën jopublike të mbajtur me datën 01.06.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hidhet poshtë padia.

Lënda t'i dërgohet Gjykatës Komunale në Vushtri, si Gjykatë kompetente.

A r s y e t i m i

Paditësi me padi ka theksuar se me vendimin e Kuvendit Komunal të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.50/2005 datë 14.01.2005, është shkarkuar nga posti i Drejtorit të Drejtorisë për Bujqësi dhe resurse natyrore në Vushtri, se me

datën 09.02.2004, ankesë i ka paraqitur Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike në Prishtinë e cila nuk ka vendosur për ankesën edhe me kalimin e afatit prej 90 ditëve, për çka me padi kërkon që të anulohet vendimi i kontestuar të detyrohet e paditura të e kthej në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Gjykata konstaton se në këtë çështje padia nuk është e lejuar.

Në nenin 9 par.1 pika 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" nr.4/1977), parashihet se nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ kundër akteve të marrura në çështjet për të cilat në bazë të dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/36 datë 22.12.2001, në nenin 11.6 parasheh se asgjë nuk mund të pengojë të drejtën e një nënpunësi civil për shqyrtimin procedural të vendimit përfundimtar administrativ në pajtim me ligjin në fuqi.

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta ("Gaz.zyr.e RSFJ" nr.21/1978), në nenin 26 par.1 pika 7 parasheh kompetencën reale të Gjykatës Komunale për të gjykuar kontestet nga marrëdhënia e punës.

Në këtë drejtim Ligji i Procedurës Kontestimore ("Gaz. Zyr.e RSFJ" nr.4/1977) në nenin 65 parasheh se në kontestin nga marrëdhënia e punës nëse paditësi është i punësuar - punëtorë, për gjykim është kompetente përpos Gjykatës që ka kompetencë të përgjithshme për të paditurin edhe Gjykata në territorin e së cilës kryhet apo është kryer puna respektivisht Gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi i kontestuar dhe procedura e cila i ka paraprirë marrjes së atij vendimi nuk e kanë karakterin e aktit dhe procedurës administrative si parashihet me nenin 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative e duke pasur parasysh dispozitat e ligjeve të caktuara më lartë, gjen se kompetente për të vendosur këtë kontest është Gjykata Komunale në Vushtri dhe për këto arsye padinë e hudhi poshtë si të palejuar, në vështrim të nenit 30 par.1 pika 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.nr.383/2005, datë 01.06.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i Kolegjit,  
Osman Tmava

**[Gjykata Supreme - Aktvendim mbi konfliktin administrativ - padia e hedhur poshtë - lënda e përcjellur Gjykatës Komunale kompetente - Neni 9 (1) pika 2 LKA/Neni 26 (1) pika 7 LGJR/Neni 65 LPK/Neni 30 (1) pika 5 LKA/Neni 11.6 i Rregullorës së UNMIK-ut Nr. 2001/36]**

*Paditësi paraqiti ankesë kundër vendimit të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë dhe Bordit të Pavarur Mbikëqyrës të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Kuvendi Komunal i Vushtrrisë shkarkoi paditësin nga detyra e drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Publike.*

*Gjykata Supreme vendosi se kërkesëpadia nuk mund të paraqitet në këtë rast dhe se në bazë të nenit 26 (1) pika 7 e Ligjit për Gjykatat e Rregullta dhe nenit 65 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore ky kontest i punës bie në kuadër të kompetencës lëndore të gjykatës komunale. Prandaj, Gjykata Supreme ka vendosur se ankesa e paditësit ishte e pabazë dhe i'a përcjelli lëndën Gjykatës Komunale në Vushtri.*

A.nr.384/2005

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Osman Tmava kryetar, Vjosa Nimani-Zylfiu dhe Meleqe Behxheti, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Ajna Gashi, procesmbajtëse, në kontestin administrativ sipas padisë së paditësit V. K., nga Vushtria, kundër vendimit të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë 01.Nr.48/05 të datës 14.01.2005, për shkak të heshtjes së administratës, në seancën jopublike të mbajtur me datën 01.06.2005, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hidhet poshtë padia.

Lënda t'i dërgohet Gjykatës Komunale në Vushtri, si Gjykatë kompetente.

A r s y e t i m i

Paditësi me padi ka theksuar se me vendimin e Kuvendit Komunal të Komunës së Vushtrrisë 01.Nr.48/2005 datë 14.01.2005, është shkarkuar nga posti i Drejtorit të Drejtorisë për Shërbime Publike të KK. Vushtri, se me datën

11.02.2005, ankesë i ka paraqitur Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës pranë Ministrisë së Shërbimeve Publike në Prishtinë e cila nuk ka vendosur për ankesën edhe me kalimin e afatit prej 90 ditëve, për çka me padi kërkon që të anulohet vendimi i kontestuar të detyrohet e paditura të të kthej në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Gjykata konstaton se në këtë çështje padia nuk është e lejuar.

Në nenin 9 par.1 pika 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative ("Gazeta Zyrtare e RSFJ" nr.4/1977), parashihet se nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ kundër akteve të marrura në çështjet për të cilat në bazë të dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.

Rregullorja e UNMIK-ut nr.2001/36 datë 22.12.2001, në nenin 11.6 parashihet se asgjë nuk mund të pengojë të drejtën e një nënpunësi civil për shqyrtimin procedural të vendimit përfundimtar administrativ në pajtim me ligjin në fuqi.

Ligji mbi Gjykatat e Rregullta ("Gaz.zyr.e RSFJ" nr.21/1978), në nenin 26 par.1 pika 7 parashihet kompetencën reale të Gjykatës Komunale për të gjykuar kontestet nga marrëdhënia e punës.

Në këtë drejtim Ligji i Procedurës Kontestimore ("Gaz. Zyr.e RSFJ" nr.4/1977) në nenin 65 parashihet se në kontestin nga marrëdhënia e punës nëse paditësi është i punësuar - punëtorë, për gjykim është kompetente përpos gjykatës që ka kompetencë të përgjithshme për të paditurin edhe Gjykata në territorin e së cilës kryhet apo është kryer puna respektivisht Gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi i kontestuar dhe procedura e cila i ka paraprirë marrjes së atij vendimi nuk e kanë karakterin e aktit dhe procedurës administrative si parashihet me nenin 6 të Ligjit për Konfliktet Administrative e duke pasur parasysh dispozitat e ligjeve të caktuara më lartë, gjen se kompetente për të vendosur këtë kontest është Gjykata Komunale në Vushtri dhe për këto arsye padinë e hudhi poshtë si të palejuar, në vështrim të nenit 30 par.1 pika 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
A.nr.384/2005, datë 01.06.2005

Procesmbajtëse,  
Ajna Gashi

Kryetar i Kolegjit,  
Osman Tmava

326 bosh